

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LIGJ

Nr. 100/2020

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT FINANCIAR  
USHTARAK NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË DHE  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit financiar ushtarak ndërmjet qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Miratuar në datën 23.7.2020

